



Pranuar / Dërguar Priljezura / Priljezura Received / Delivery	29. 03	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHI	1680	2022	1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.124/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.124/2022 të datës 14.02.2022 të parashtruar nga ankuesit [redacted] dhe [redacted] i regjistruar në emër të ankuesit [redacted] me adresë banimi: [redacted] Komuna Prishtinë, kundër Vërejtjes me numër:04/312 të Zv/ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të datës 14.01.2022, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET si e bazuar** ankesa A.nr.124/2022 e parashtruar më datë 14.02.2022 nga ankuesit [redacted]
- II. **SHFUQIZOHET** Vërejtja me numër:04/312 e Zv/Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e datës 14.01.2022.
- III. **OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesit, [redacted] dhe [redacted] me datë 14.02.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil kundër Vërejtjes me numër:04/312 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të datës 14.01.2022 me pretendimet ankimore se vërejtja e shqyrtuar përmban të meta dhe shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, shkelje procedurale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 18.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ndërsa të njëjtit nuk ia janë përgjigjur kërkesës së dërguar Këshilli pavarësisht obligimeve ligjore që kanë.

Pas telefonatës së realizuar me zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilët e konfirmojnë pranimin e kërkesës, Këshilli me datë 22.03.2022 i ka dërguar sërish kërkesën nëpërmjet e-maili në të cilin kanë qenë të përfshirë: [redacted] i cili njëherit është edhe Zv/ Sekretar i Përgjithshëm, [redacted] dhe [redacted] ndërsa deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi, provat e kërkuara nuk janë ofruar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesve të datës 14.02.2022 me numër protokolli 710/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Vërejtjen me numër:04/312 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e datës 14.01.2022; Kërkesën për Përgjigje në ankesë të datës 18.02.2022; E-mailin e dërguar me datë 22.03.2022 nga Këshilli për zyrtarët e ministrisë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ekziston bazë e mjaftueshme ligjore që ankesa e ankuesve të aprovohet **si e bazuar**, sepse:

Kolegji, në bazë të shkresave dhe deklarimeve të ankuesve në ankesën e datës 14.02.2022, ka konstatuar se ankuesi [redacted] është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në pozitën “Drejtor i Departamentit për Transport Rrugor”, ndërsa ankuesi [redacted] në pozitën “Drejtor i Departamenti të Infrastrukturës Rrugore”.

Në bazë të vërejtjes së datës 14.01.2022 me numër:04/312, Kolegji ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës iu ka shqiptuar të gjithë Drejtorëve të Departamenteve dhe Udhëheqësve të Divizioneve të cilët i raportojnë drejtpërdrejt atij, pa e përcaktuar emër për emër për secilin veç e veç, me arsyetimin, citoj; *“Meqenëse në shumë Departamente janë përsëritur shkelje të ndryshme si mosrespektimi i orarit të punës nga zyrtarët, vonesa në dorëzimin e raporteve, përsëritje të rekomandimeve të njëjta në raportet e Auditimit, cilësia e dobët e dokumenteve të pranuar, si dhe duke pas parasysh se mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë nuk kanë marr asnjë ndaj këtyre shkeljeve, me qëllim që këto shkelje dhe lëshime të mos përsëriten, si dhe me qëllim që të ngritet performanca e punës, lëshohet kjo vërejtje për ndërmarrjen e veprimeve nga menaxhmentin i MMPHI”.*

Me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik neni 2 paragrafi 1 ku përcaktohet se: ‘1. Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë’ si dhe nenit 50 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“Parimet e individualizimit të masave disiplinore 1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit”* si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 44 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 ku përcaktohet se: *“Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike, dhe: 1.1. u drejtohet një ose disa personave individualisht të përcaktuar (në vijim: “akti administrativ individual”, gjegjësisht “kolektiv”)”* si dhe nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, 1.3 dhe 1.4 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1 pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.3 pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin) dhe 1.4 pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për*

mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmblylëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë” si dhe nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafët 1.3, 1.4 dhe 1.5 i të njëjti ligj ku përcaktohet se: “1.3. është rezultat i shkëljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material.

Andaj, Kolegji ka gjetur se vërejtja e datës 14.01.2022 me numër:04/312, e shqiptuar nga Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës askund në asnjë pjesë të saj nuk i referohet dispozitave të ligjit material, e njëjta nuk përmban në mënyrë taksative emrat apo nuk identifikohen me emër ankuesit respektivisht atyre që iu është shqiptuar masa disiplinore, nuk është zbatuar parimin e individualizimit të masave siç përcaktohet edhe në ligjin material, aktit i mungon arsyetimi mjaftueshëm se për cilin veprim cili nga ankuesit është përgjegjës në rastin konkret dhe pse kanë qenë të zbatueshme dispozitat ligjore në këtë mënyrë, aktit i mungon këshilla mbi ushtrimin e mjeteve juridike dhe mbi këtë bazë Kolegji konstaton se vërejtja e datës 14.01.2022 me numër:04/312 e shqiptuar nga Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ndaj ankuesve [redacted] dhe [redacted] është e paligjshme për arsyet sikurse i kemi specifikuar si më lartë në këtë vendim ne pajtim me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa ankesa e ankuesve aprovohet si e bazuar kurse vërejtja në fjalë shfuqizohet.

Po ashtu, Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës masën disiplinore të ankuesve obligohet ta shuaj nga dosja e tyre e personelit siç përcaktohet me nenin 51 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik: “Deklarimi i shuarjes bëhet sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë, me vendim të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit. Masa fshihet nga dosja e personelit dhe nga regjistri përkatës”. Ndërsa, Zv/Sekretari i Përgjithshëm i cili ushtron detyrat dhe përgjegjësit e Sekretarit të Përgjithshëm Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në të ardhmen në rastet kur ka prova ose pretendon se zyrtarë të caktuar kanë kryer shkelje të detyrave të punës, qoftë në cilësi të Udhëheqësit të Drejtpërdrejt apo Zyrtarit Kryesor administrativ, shqiptimin e masave disiplinore apo inicimin e procedurave disiplinore duhet ta bëjë në pajtueshmëri me dispozitat e aplikueshme ligjore për shërbimin civil si dhe duhet t’i evitojë të metat juridike të veprimeve procedurale administrative, respektivisht nxjerrjes së akteve të specifikuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi.

Zyrtari Kryesor Administrativ duhet ta ketë parasysh se obligohet të bashkëpunojë me Këshillin, siç përcaktohet me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht nenin 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe nenin paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës: “Me qëllim të ushtrimit të funksioneve, Këshilli ka të drejtë të: ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil dhe 2. Këshilli parapraakisht e njofton zyrtarin kryesor administrativ të organit përkatës të punësimit, për çfarëdo vizite apo kërkesë për informata lidhur me zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil”, ndërsa ZKA ka qenë i njoftuar me kërkesën e cila dëshmohet edhe përmes konfirmimit elektronik se i njëjti e-mailin me kërkesën e përsëritur të datës 22.03.2022 e ka hapur dhe lexuar në po të njëjtën ditë në ora 10:02 minuta.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.124/2022

**Flakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesve
- Zv/Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

